

VEPËRIM I UDHEZIME, SHKRESA, KËRKESA
NR 10634 DATE 24.6.2021
DEKUAR NGA:
LËNDA:



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 10876 Prot

Tiranë, më 18/06/2021

Lënda: Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024

BASHKISË shkodër

KËSHILLIT TË QARKUT _____

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe të udhëzimit vjetor të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.7 datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije që procesi dhe procedura e vazhimit të fazës së dytë për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor do të zbatohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

ANALIZA E PBA 2022-2024

BASHKIA SHKODËR

A. Vështrim i Përgjithëm

Bashkia Shkodër e ka paraqitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” në mënyrë të plotë dhe të strukturuar sipas standarteve të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Bazuar në raportimin sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar bashkia Shkodër ka nën juridiksion një popullsi prej 210,182 banorësh dhe kryen funksionin me një numër prej 1,021 punonjës me kohë të plotë dhe 81 punonjës me kohë të pjesshme, ndërkohë për periudhën afatmesme parashikohen 1,060 punonjës në organikë.

Bashkia Shkodër planifikon që në vitin 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti, si një lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë ku ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Bashkia Shkodër mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Zona urbane e Shkodrës ka nevojë të krijojë qëndërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qëndërsi të reja urbane konsolidojnë strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale kanë nevojë për të përmirësuar qendrat ekzistuese. Kjo qasje do të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore.

B. Lista e Programeve të Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër e ka planifikuar ushtrimin e veprimtarisë për periudhën 2022-2024 të ndarë në programet e mëposhtme. Bashkia ka paraqitur shumë qartë për çdo program qëllimin e politikës, objektivat specifik që do të arrihen, treguesit e rezultatit dhe periudhën kohore gjatë së cilës synohet realizimi.

1. Planifikim, Menaxhim dhe administrim (01110)
2. Gjendje Civile (01170)
3. Shërbimet e policisë vendore (03140)
4. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)
5. Mbështetja për zhvillimin ekonomik (04130)
6. Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi (04160)
7. Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve (04220)
8. Menaxhimi i ujëtjes dhe kullimit (04240)
9. Administrimi i pyjeve dhe kullotave (04260)
10. Rrjeti rrugor rural
11. Transporti publik (04570)
12. Zhvillimi i turizmit (04760)
13. Menaxhimi i mbetjeve (05100)
14. Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve (05200)

15. Programe të mbrojtjes së mjedisit (05320)
16. Ndërgjegjësimi mjedisor (05630)
17. Planifikimi urban vendor (06140)
18. Shërbimet publike vendore (06260)
19. Furnizimi me ujë (06330)
20. Ndriçim rrugësh (06440)
21. Shërbimet e kujdesit parësor (07220)
22. Sport dhe argëtim (08130)
23. Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore (08220)
24. Arsimi bazë dhe parashkollor (09120)
25. Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)
26. Arsimi profesional (09240)
27. Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët (10430)
28. Strehimi Social (10661)

Mbi bazën e këtyre programeve është organizuar sipas funksioneve buxheti i bashkisë Shkodër duke orientuar gjithashtu edhe mënyrën e përqendrimit të fondeve buxhetore në fusha të caktuara.

C. Komente të Përgjithshme

- Programi buxhetor afatmesëm për periudhën 2022-2024 është përgatitur nga Bashkia Shkodër bazuar në Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe tabelat janë plotësuar saktë me të gjithë informacionin e nevojshëm që mund të ndihmojë në analizën e projektbuxhetit afatmesëm.
- Bashkia Shkodër e ka dorëzuar programin buxhetor afatmesëm brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin nr.7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024” (dorëzimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë brenda datës 1 qershor 2021);
- Raportet e përcjella në Ministrinë e Financave nga Bashkia Shkodër janë në përputhje të plotë me përcaktimet e udhëzimit dhe paraqesin informacionin e nevojshëm financiar duke ndihmuar në analizën e informacionit mbi programin buxhetor afatmesëm të njësisë 2022-2024 ;
- Bashkia Shkodër i ka paraqitur të gjitha formatet e kërkuara, përmes të cilave do të realizohet analiza e performancës buxhetore afatmesme. Këto formate do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e buxhetit dhe mbi bazën e tyre do të jepen rekomandimet e nevojshme.
- Përmbajtja e formateve së bashku me relacionin e dërguar janë plotësuar në përputhje të plotë me përcaktimet e udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë;

D. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

Gjatë vitit 2021 dhe në vazhdim për periudhën afatmesme, Bashkia Shkodër referuar tabelës F1 “Burimet Buxhetore”, siguron të ardhura nga burimet e veta (taksat dhe tarifatat vendore) dhe nga transfertat e buxhetit qendror, si burime kryesore të financimit të aktivitetit vjetor dhe afatmesëm të kësaj njësie. Duke u mbështetur në tabelën e sipërcituar konstatojmë që një pjesë të madhe të burimit të financimit të bashkisë Shkodër vjen nga të ardhurat në formën e transfertës nga buxheti qendror dhe pas saj të ardhurat e veta të NJVQV-së. Gjithashtu, edhe në periudhë afatmesme megjithë parashikimin e rritjes së nivelit të të ardhurave të veta, bashkia ka parashikuar që kjo

diferencë (të ardhurat nga buxheti qendror-të ardhurat e veta) të jetë pothuajse në të njëjtat nivele. Ky tregues rekomandohet të ndryshohet përmes përmirësimit të mbledhshmërisë së të ardhurave të veta buxhetore duke synuar tejkalimin e masës së fondeve që bashkia përfiton në formën e transfertave nga buxheti qendror, ose së paku ecjen në trendin zbritës në periudhën afatmesme të diferencës midis të ardhurave nga transfertat e buxhetit qendror - të ardhurat e veta.

Tendenca e rritjes së të ardhurave në vite:

Referuar të dhënave të mëposhtme mbi burimin e të ardhurave të Bashkisë Shkodër në vitet e shkuara buxhetore, vitin aktual dhe 3 vitet e ardhshme konstatojmë si më poshtë:

- Buxheti i Bashkisë së Shkodër për vitin 2022 është planifikuar në total në vlerë 3,007,598 mijë lekë, ndër të cilat 848,472 mijë lekë nga të ardhurat e veta (28.2%), ndërsa pjesa tjetër nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, sektoriale dhe e kushtëzuar dhe të ardhura të trashëguara nga vitit 2021;
- Ky raport i të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave të bashkisë Shkodër, në vite ka ardhur në rritje krahasuar me vitin 2019 dhe 2020. Sugjerohet që në periudhë afatmesme të synohet nga Bashkia Shkodër përmirësimi i këtij raporti përmes rritjes së të ardhurave të veta në raport me të ardhurat totale si një mënyrë e rëndësishme e rritjes së kapacitetit fiskal.
- Për vitin 2023 është planifikuar në total në vlerë 3,032,530 mijë lekë, ndër të cilat 852,703 mijë lekë nga të ardhurat e veta (28.1%), ndërsa pjesa tjetër nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, sektoriale dhe e kushtëzuar;
- Për vitin 2024 është planifikuar në total të ardhura, në vlerë 3,082,658 mijë lekë, ndër të cilat 853,202 mijë lekë nga të ardhurat e veta (27.6%) duke e ulur përsëri raportin kundrejt të ardhurave të veta, ndërsa pjesa tjetër nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, sektoriale dhe e kushtëzuar;
- Të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe transfertat nga buxheti i shtetit përbëjnë një burim kryesor të ardhurash, por duke paraqitur në këtë mënyrë një situatë financiare e cila i mundëson bashkisë Shkodër të realizojë politika të favorshme investimi që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve nën juridisionin e saj. Nisur nga fakti se këto politika theksohen në periudhë afatmesme konstatohet një ulje e peshës që zënë të ardhurat nga burimet e veta në totalin e buxhetit vendor.
- Të ardhurat në formën e transfertës nga buxheti qendror për vitin 2022 janë 2,158,080 mijë lekë dhe një trashëgim me destinacion prej 1,046 mijë lekë, për vitin 2023 janë parashikuar 2,179,827 mijë lekë dhe për vitin 2024 janë parashikuar 2,229,456 mijë lekë dhe përfshijnë transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, sektoriale dhe transfertën e kushtëzuar;
- Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2022-2024 janë kryesisht taksa mbi pasurinë e paluajtshme, taksa e ndikimit në infrastruktuë nga ndërtimet e reja, tarifa për menaxhimin e mbetjeve, tarifat për shërbimet administrative. Të ndara sipas zërave pjesa tjetër e burimeve zënë një përqindje të ulët në raport me totalin e mbledhshmërisë që siguron kjo njësi.
- Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore

Në tërësi buxheti i Bashkisë Shkodër ka një shpërndarje të drejtë të burimeve të financimit të projektbuxhetit afatmesëm. Rekomandohet që të ndryshohet raporti i burimeve të financimit të

njesisë duke synuar që në kushtet e një potenciali zhvillimi ekonomik përqindja që zënë burimet nga të ardhurat e veta të tejkalojnë burimet nga trasfertat e buxhetit qendror. Përmes kësaj politike fiskale bashkia Shkodër do të sigurojë autonomi më të lartë buxhetore dhe performancë në investime vendore që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve nën juridiksionin e saj. Rritja e të ardhurave nga burimet e veta financiare do të shoqërohet me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe investime të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.

Shpenzimet

Analiza e shpenzimeve buxhetore të Bashkisë Shkodër në vite është një instrument i rëndësishëm për të kuptuar financimin e prioriteteve që do të realizohen në periudhën afatmesm. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Referuar tabelës të PBA 2022-2024 të bashkisë Shkodër, konstatojmë se krahasuar ndër vite, shpenzimet në total në vitin 2022 janë parashikuar me një ulje prej 4.5 % ndaj 2021, në vitin 2023 me një ulje prej 1 % ndaj 2022 dhe në vitin 2024 me një rritje prej 1.6 për qind ndaj 2023.

Parë në këndvështrimin e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike konstatohet që peshën më të vogël në shpenzime e zënë shpenzimet për investime, ndërkohë që shpenzimet operative për periudhën afatmesme zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të shpenzimeve (62%). Referuar planifikimit të paraqitur nga bashkia në PBA 2022-2024 në përqindje për secilin vit raporti i shpenzimeve për investime ndaj totalit paraqitet: 11.4 % për vitin 2022, 12.1 % për vitin 2023, dhe 11.3 %, në këndvështrimin buxhetor ky raport është i ulët. Si rrjedhojë rekomandojmë që bashkia Shkodër duhet të ndryshojë këtë raport duke ulur nivelin e shpenzimeve operative dhe duke rritur nivelin e shpenzimeve për investime me qëllim rritjen e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve.

Mbështetur në analizën sipas programeve pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë programet: “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim (9.3%), Rrjeti rrugor rural (10.1%), Menaxhimi i Mbetjeve (6.4%), Arsimi Bazë përfshirë arsimin parashkollor (10.7%), Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët (36.2%).

Shpenzimet e personelit (600+601)

Shpenzimet e personelit në vitin 2022 parashikohet të zënë 25.4% në raport me totalin e shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, ndërkohë që pothuajse të njëjtën peshë zënë edhe për vitet e tjera. Konstatojmë se rritja e shpenzimeve operative nga viti në vit është e qëndrueshme.

Shpenzimet Operative (602-606)

Shpenzimet operative në vitin 2022 parashikohet të zënë 62 % ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, ndërkohë që edhe në vitet pasuese parashikohen të zënë të njëjtin nivel ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara. Nga sa më sipër konstatohet që sipas llogarive ekonomike këto shpenzime zënë një pjesë të ndjeshme të buxhetit të bashkisë. Rekomandojmë që shpenzimet operative të jenë tq qëndrueshme dhe në rënie të vazhdueshme në funksion të rritjes së investimeve të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.

Shpenzimet për Investime (230-231)

Shpenzimet për investime në vitin 2022 parashikohen të zënë 11.4% të totalit të shpenzimeve të bashkisë Shkodër të parashikuara për këtë vit, në vitin 2023 dhe 2024 parashikohen pothuajse në të njëjtat nivele. Referuar të dhënave të programit buxhetor afatmesëm bashkia Shkodër ka një peshë të ulët të shpenzimeve për investime në vlerë absolute, por gjithashtu edhe në raport me buxhetin. Konstatohet se shpenzimet për investime përbëjnë zërin më të ulët të shpenzimeve buxhetore, si rrjedhojë rekomandohet që në vitet në vazhdim të synohet rritja e peshës së investimeve me qëllim rritjen e performacës së njësisë vendore.

Shpenzimet e programeve sipas produkteve

Bashkia Shkodër ka paraqitur në Programin Buxhetor Afatmesëm një analizë për performacën e çdo programi dhe objektivat për periudhën afatmesme. Gjithashtu për çdo program është evidentuar përshkrimi i programit, qëllimi i politikës së programit, objektivat dhe treguesit e performancës, produktet sipas programeve, si dhe të dhëna e statistika të përgjithshme për çdo program. Vlerësojmë punën e Bashkisë Shkodër për plotësimin e programeve në përputhje me tabelat 6 dhe 7 të shojcës 2 të udhëzimit. Disa prej produkteve të evidentuara për dy programe kryesore të bashkisë për periudhën 2022-2024, janë:

Për programin 06260 “Shërbimet publike vendore”

- Sipërfaqe publike e mirëmbajtur në zonat urbane dhe rurale
- Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve
- Dekorimi i mjediseve publike
- Mirëmbajtja e hapsirave të gjelbërta

Për programin 04520 “Rrjeti rrugor rural”

- Mirëmbajtje rrugë, sheshe dhe trotuare urbane në territorin e bashkisë Shkodër
- Rikonstruksion rrugë urbane
- Rikonstruksion sheshe urbane
- Rrugë të mirëmbajtura në njësi administrative
- Rikonstruksion i rrugëve rurale

E. Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme

Bashkia Shkodër në një aneks të veçantë ka paraqitur projektet e investimeve mbështetur në objektivat strategjik, të lidhura me Planin e Përgjithshëm Vendor. Për çdo program janë paraqitur projektet e investimeve duke përcaktuar edhe burimin e financimit. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara janë projekte infrastrukturore. Disa projekte kryesore të paraqitura në shtojcën 2 të dokumentit janë:

- Investimi i bregut perëndimor të liqenit Shkodër
- Rruga “Shirokë - Zogaj”
- Projekti “rikonstruksioni i rrugës Qafë Thore – Theth

- Përfundimi i by passit të qytetit
- Projektimi dhe zbatimi i ndërtimit të impiantit të përpunimit të ujrave

F. Detyrimet e prapambetura

Bashkia Shkodër bazuar në formacion F3 “Detyrimet e Prapambetura” të Instrumentit të Planifikimit Financiar ka paraqitur informacion mbi detyrimet e prapambetura dhe amortizimin e tyre. Stoku i borxhit i paraqitur është në vlerën 571 mijë lekë, të cilin bashkia Shkodër parashikon ta shlyejë brenda vitit 2021.

G. Treguesit kryesorë financiarë

Treguesit paraqesin një pamje të drejtë dhe justifikojnë madhësinë e burimeve nga e cila financohet bashkia Shkodër. Konstatohet se taksat dhe tarifat lokale kundrejt totalit të të ardhurave në periudhën afatmesme janë në masën rreth 23 për qind. Norma e të ardhurave nga burimet e veta kundrejt të ardhurave të përgjithshme është përkatësisht 28.2 për qind në vitin 2022, 28.1 për qind në vitin 2023 dhe 27.7 për qind në vitin 2024, duke treguar se peshën më të madhe të buxhetit në bashkinë Shkodër vazhdojnë ta zënë të ardhurat nga buxheti qendror. Shpenzimet korrente zënë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit në krahasim me shpenzimet për investime, në masën 89 për qind, ndërkohë që shpenzimet për investime paraqiten në nivele shumë të ulëta në masën rreth 11.5 për qind.

H. Raporti i objektivave të synuar

Në një periudhë afatmesme bashkia Shkodër ka paraqitur shumë qartë për çdo program qëllimet dhe objektivat e synuar, duke u mbështetur në burimet e veta dhe ato qendrore për realizimin e tyre.

Rekomandime

Roli kryesor i PBA-së është të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë si dhe programet/produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore.

Rekomandojmë të rritet ndjeshëm për vitet në vazhdim raporti që zënë burimet e veta të financimit të njësisë me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe aftësisë së bashkisë për të ofruar shërbime cilësore në komunitet.

Rekomandojmë që në periudhën afatmesme pesha që do të zënë shpenzimet operative ndaj totalit të ulet në funksion të rritjes së shpenzimeve për investime, duke u shoqëruar me një rritje të eficiencës së bashkisë nëpërmjet ofrimit të një niveli më të lartë investimesh dhe një shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.

